REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 62/17
Date/Datum 28.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	**27.03.2017**
REFERENC-Ë:	**62/17**
PËR/ZA/TO:	**AK - Universiteti i Prishtinës – "Hasan Prishtina".** **OE - NTP "KGT" – Prishtinë.**
NGA/OD/FROM:	**z. Ekrem Salihu – Kryetar i Panelit Shqyrtues**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**N j o f t i m**

Operatori Ekonomik: NTP "KGT" -- Prishtinë, si palë e pa kënaqur më datën: 01.03.2017, ka parashtruar ankesë me nr. **63/16,** në Organin Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për anulim të lotit 2, të aktivitetit të prokurimit me titull: **"Blerja e librave në gjuhën shqipe dhe gjuhen angleze",** me nr. të Prokurimit: **90400/16/032/121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "**Universiteti i Prishtinës**", duke pretenduar se autoriteti kontraktues, nuk e ka respektuar nenin, 1, 7, 51, 54 dhe 59 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 07.03.2017 ,ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të OE NTP "KGT", nga Prishtinë.

Eksperti shqyrtues me datën: 16.03.2017, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tijë, në lidhje me ankesën e lartpërmendur, me ç'rast ka vlerësuar se pretendimet e OE NTP "KGT" – Prishtinë, janë të qëndruesheme, rrjedhimishtë ka rekomanduar panelin shqyrtues që lotin 2, të këtijë aktiviteti të prokurimit ta kthej në Ri-vlerësim.

Me datën: 24.03.2016, Autoriteti Kontraktues: "Universiteti i Prishtinës", si dhe OE ankues: "PBC"shpk – Prishtinë, e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e librave në gjuhën shqipe dhe gjuhen angleze",** me nr. të Prokurimit: **90400/16/032/121.**

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës së datës: 23.03.2017, ka njoftuar OSHP-në, se **pajtohet** me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues në raportin e datës: 16.03.2017.

Operatori ekonomik: NTP "KGT" -- Prishtinë, përmes parashtresës së datës: 22.03.2017, ka njoftuar OSHP-në , se **pajtohet** me mendimin e dhenë të të ekspertit shqyrtues në raportin e datës: 16.03.2017.

Paneli Shqyrtues, njofton Autoritetin Kontraktues, konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: "Universiteti i Prishtinës" urdhërohet që lotin 2, të aktivitet të prokurimit me titull: **"Blerja e librave në gjuhën shqipe dhe gjuhen angleze"**, me nr. të Prokurimit: **90400/16/032/121**, ta kthejë në Ri-vlerësim, konform dispozitave të LPP-së.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e këtij urdhëri, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues NTP "KGT" – Prishtinë, konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i bëhet kthimi i sigurimit të ankesës, megjithatë i njejti obligohet që në periudhën kohore prej gjashtëdhjetë (60) diteve, të paraqes kërkesë për tërheqje të mjeteve në të kundërtën mjetet financiate do të bartën në Bugjetin e Republikës së Kosovës.